

Dialogu i Brukselit dhe shtegu drejt një marrëveshje

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) organizoi një tjetër tryezë të rrumbullakët¹, me 9 tetor 2021 në Shkup, Maqedoni e Veriut, për një numër deputetësh aktualë dhe të mëparshëm të parlamenteve të Kosovës dhe Serbisë për të diskutuar pritshmëritë e dialogut Kosovë-Serbi dhe rrugët drejt një marrëveshje. Diskutimet u mbajtën nën rregullën Chatham House. Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës mbështet iniciativën ndërsa Fondi Ballkanik për Demokraci i Fondit German Marshall të Shteteve të Bashkuara ofroi mbështetje shtesë për këtë tryezë të rrumbullakët. Raporti nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë ose të CIG por reflekton diskutimin si tërësi.

Një marrëveshje finale apo një zgjidhje e sekuencuar

Tensionet mes Kosovës dhe Serbisë për ‘targat’ treguan se rezultatet e dialogut të Brukselit mbeten të brishta. Mënyra më e mirë për të parandaluar përshkallëzime të ngjajshme është të punohet më shpejt për një marrëveshje finale. SHBA dhe BE bashkë mund të vendosin një proces negocimi i cili duhet të marrë “jo më shumë se një muaj”, sugjeroi një pjesëmarrës, duke shpjeguar se “numri i çështjeve të hapura është i vogël dhe problemet janë të njohura për të gjithë.” “Një muaj duhet të jetë i mjaftueshëm.” Ndërsa përgatiten për një marrëveshje përfundimtare, BE dhe SHBA do të mund të vendosnin një komunikim dhe bashkëpunim bazë midis Prishtinës dhe Beogradit mbi çështjet e sigurisë, përfshirë krijimin e një linje komunikimi të drejtpërdrejtë midis kryeministrave, ministrave të punëve të brendshme dhe ministrave të mbrojtjes.

Shumë thanë se incidentet e vogla, si ai i fundit mbi targave, nuk kanë të ngjarë të ndezin ndonjë konflikt të madh, por mund të nxjerrin nga binarët procesin e normalizimit dhe të minojnë dialogun e Brukselit.

Përshkallëzimi i fundit i sigurisë – armë dhe automjete të blinduara u ekspozuan nga Prishtina dhe Beogradi – përfundoi me një “marrëveshje për letrat ngjitesë”, ku të dyja palët mbulojnë me letra ngjitesë simbolet shtetërore të njëra-tjetrës në targat e makinave. Shumë folës vlerësuan se Prishtina do të ndërmer masa të reja në javët në vijim, të tilla si përpjekjet për të gjetur mënyra për të mbledhur faturat e energjisë elektrike në veri. “Këto masa mund ta komplikojnë situatën edhe më shumë.” Shumë pjesëmarrës thanë se të gjitha çështjet e mbetura “mund të zgjidhen pa armë dhe polici.” Megjithatë, disa thanë se “situata e energjisë në veri mund të çojë në një eskalim më të madh.” Një folës tha se një zgjidhje përfundimtare është e vetmja mënyrë për të parandaluar incidente të tilla. “Ne kemi nevojë për një paqe të re, jo një paqe të bazuar në frikë, por një paqe që është e qëndrueshme në vetvete.” Por periudhat parazgjedhore nuk janë kohë të mira për

¹ CIG ka organizuar diskutime ndërmjet anëtarëve të parlamenteve të Kosovës dhe Serbisë që nga viti 2015. Këto diskutime janë zhvilluar në Prishtinë, Beograd, Tiranë, Shkup, Mavrovë dhe Podgoricë.

vendime të mëdha. Prandaj, palët nuk ka të ngjarë të angazhohen në negociata serioze deri pas zgjedhjeve të tetorit 2021 në Kosovë dhe zgjedhjeve të pranverës 2022 në Serbi.

Kosova dhe Serbia duhet patjetër të angazhohen në menaxhimin e këtyre incidenteve, por fokusi i tyre kryesor nuk duhet të jetë në incidente që ndodhin herë pas here, por në “gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme, përfshirë njohjen.” “Por ne duhet të mendojmë për njohjen si një proces, jo si një akt.” Folësi tha se nëse qëllimi përfundimtar i Kosovës është njohja, atëherë pse të mos përpiqemi t’u sekuencojmë atë në faza, sepse “njohja si akt nuk ka gjasa të ndodhë.” Negociatorët duhet të kërkojnë mënyra më të pranueshme dhe më fleksibile në mënyrë që “të dyja palët të mund të ndihmojnë njëra-tjetrën për të gjetur një rrugëdalje nga ky kurth.” Ai tha se zgjidhja e problemeve të tjera do të mund të sekuencohej gjithashtu, përfshirë themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. Çështje të tjera më të vogla do të mund të sekuencoheshin poashtu, përmes “ndarjes së tyre në detyra të thjeshta të vogla që në fund do të përfundonin procesin.” Folësi shtoi se “testi i kalueshmërisë për shoqërinë kosovare është për të parë nëse ata mund ta zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për Manastirin e Deçanit.” I gjithë procesi i negociatave duhet parë “si një proces, jo si një akt apo dramë e vetme.”

Serbët dhe shqiptarët duhet gjithashtu të ndërtojnë një kuptim të përbashkët të asaj se çfarë do të thotë “marrëveshja përfundimtare”. Një folës tjetër tha se “marrëveshja përfundimtare do të thotë pak a shumë njohje,” por se “njohja nuk do të ndodhë në afat të shkurtër dhe afatmesëm” dhe kjo është arsyeja pse vendimmarrësit duhet të përqendrohen në atë që është e mundur tani. Ndoshta fokusimi në arritjen e marrëveshjeve që trajtojnë çështje të tilla si pensionet, pretendimet financiare dhe pronat. Marrëveshjet e bazuara në këto çështje mund të ndërtojnë bazën për një marrëveshje përfundimtare. Një folës tha se marrëveshja përfundimtare duhet të jetë e detajuar dhe me udhëzime dhe afate kohore të qarta për zbatim. Marrëveshja finale duhet të jetë si “plani i Ahtisaarit, shumë i detajuar dhe shumë konkret.”

Përderisa pjesëmarrësit u pajtuan se marrëveshja përfundimtare është e pashmangshme, shumë argumentuan se gjasat që ajo të ndodhë shpejt janë të vogla. Së pari, besimi në mes të dy palëve është i dobët. Së dyti, duke dështuar vazhdimisht në zotimet e tyre për zbatimin e marrëveshjeve të arritura, Kosova dhe Serbia e kanë dëmtuar kredibilitetin e tyre si negociatorë të besueshëm. Dhe së treti, asnjëra palë nuk duket e gatshme të bëjë kompromiset e nevojshme për arritjen e një marrëveshjeje të përhershme.

Shumë folës e konsideruan mbështetjen ndërkombëtare si kyçe për të çuar procesin drejt një përfundimi të suksesshëm. “Prishtina dhe Beogradi nuk mund të arrijnë marrëveshje të mëdha vetëm.” Nëse SHBA dhe BE nuk ofrojnë më shumë së vetëm lehtësim të dialogut, dialogu mund të vazhdojë pafundësisht. Kosova dhe Serbia nuk janë të gatshme as të implementojnë atë për çka janë dakorduar, e lëre më të arrijnë marrëveshje të reja. Problemi të Kosova dhe Serbia është se “kompromisi shihet si dobësi.” Frika është një tjetër element që ndikon në vendimmarrje. Një folës shpjegoi se Asociacioni/Bashkësia nuk është kërcënim ashti siç është në letër, por se palët po përpiqen të shtojnë gjëra të reja dhe të ndryshojnë të vjetrat, përderisa negociojnë implementimin. “Prishtina nuk ka frikë nga kompetencat e reja për komunat me shumicë serbe, por ka frikë se për çfarë do të përdoren eventualisht këto kompetenca të reja.” Zyrtarët e Kosovës dhe Serbisë duhet t’i adresojnë këto frika në mënyrë që të ndërtojnë një dialog më të sinqertë.

Një sfidë tjetër është se Kosova dhe Serbia e shohin dialogun e Brukselit si një 'lojë' në të cilën fitorja e njëres palë nënkupton humbjen e palës tjetër. Nuk mund të ketë një rrugë të qartë drejt normalizimit ku secila palë ka përkufizimin e vet për atë se cka do të thotë normalizim i marrëdhënieve. Gjithashtu nuk është e qartë nëse palët duan një zgjidhje. "Sapo zgjidhja të bëhet objektiv i përbashkët, arritja e një marrëveshjeje do të bëhej shumë më e lehtë." Një dialog ku palët nuk kanë objektiva të qarta nuk ka gjasa të përfundojë me një marrëveshje. "Një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk është thjesht një tekst për një mosmarrëveshje, por një marrëveshje që do të duhej të përcaktonte një marrëdhënie të re ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe shoqërive të tyre përkatëse; është një marrëveshje që do të shkonte përtej një akti të thjeshtë të njohjes diplomatike."

Disa pjesëmarrës folën sekuencimin e procesit. Një folës argumentoi se Beogradi që nga fillimi e ka sekuencuar procesin e tij në tri faza: Beogradi filloi dialogun me Prishtinën në vitin 2010, arriti një numër marrëveshjeesh gjatë pesë viteve dhe përfundoi fazën e parë në vitin 2015. Faza e dytë është procesi i integritimit në BE. Dhe faza e tretë ka të bëjë me zbatimin e një marrëveshjeje eventuale me Kosovën dhe reformat e kërkuara nga BE-ja. Kapitulli 35 numëron çështjet me Kosovën që Serbia duhet t'i adresojë për ta mbyllur këtë fazë me sukses. Folësi rekomandoi që palët të përpiqen të bien dakord për një sekuencim të përbashkët. Kjo mund të bëhet duke zgjeruar dialogun për të përfshirë komunikimin e drejtpërdrejtë, jo vetëm nëpërmjet lehtësimit ndërkombëtar. Sekuencimi duhet të përfshijë gjithashtu një numër çështjesh për të drejtat e njeriut dhe të pakicave.

Kosova gjithashtu mund të sekuencojë procesin e saj të dialogut dhe objektivat. Mund të fillojë me kërkimin e njohjes nga pesë jo-njohësit e BE-së, t'i afrohet NATO-s dhe BE-së, dhe në fazën e tretë të synojë njohjen e Serbisë në kohën kur Serbia është gati të përfundojë fazën e tretë, anëtarësimin në BE. "Njohja e Kosovës është një kusht i panegociueshëm për anëtarësimin e Serbisë," argumentoi një folës. Shumë folës u pajtuan se nuk ka gjasa që Serbia ta njohë Kosovën brenda një kohe afatshkurtër, por se ajo mund të "njohë ekzistencën e Republikës së Kosovës, pa njohje diplomatike."

Ndërkohë, palët duhet të sigurohen që incidentet të mos dalin jashtë kontrollit. "Çështja e energjisë elektrike është edhe më e ndërlikuar se target." Një folës shpjegoi se katër komunat me shumicë serbe në veri shpenzojnë rreth 22 milionë euro energji elektrike në vit dhe nuk paguajnë asgjë. Qeveria e Kosovës pagoi 11 milionë euro në prill për të mbuluar shpenzimet për gjashtë muaj, periudhë që skadoi në tetor. "Qeveria e Kosovës nuk do të subvencionojë më energjinë elektrike për veriun". Por nuk është e qartë se si qeveria planifikon t'i mbledhë faturat.

Sipas marrëveshjes fillestare për energjinë të arritur në vitin 2013²—marrëveshja është rishikuar dhe zbatuar në vitin 2019 pa miratimin e Serbisë³—Operatori Kosovar i Transmisionit (KOSTT) bëhet anëtar i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (ENTSO-E) ndërsa një kompani e re e energjisë elektrike do të themelohet për të furnizuar me energji elektrike dhe për të ofruar shërbime të shpërndarjes (si faturimi, arkëtimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike e konsumatorëve të rinj) për konsumatorët në katër komunat me shumicë serbe në veri. Marrëveshja nuk u zbatua. Dhe në vitin 2019, pasi pësuan ndërprerje në orët e tyre, BE rishikoi marrëveshjen origjinale pa miratimin e Serbisë dhe vazhdoi me zbatimin.

Tani një kompani e re e energjisë elektrike është regjistruar në Kosovë për t'i shërbyer komunave veriore, por është në pritje të licencimit nga autoritetet e Kosovës. Thuhet se diskutimet mes qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve serbë për gjetjen e një zgjidhjeje për energjinë elektrike për veriun janë duke vazhduar. Megjithatë, shumë pjesëmarrës ishin të shqetësuar se një përshkallëzim tjetër do të përkeqësonte edhe më tej marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve dhe do të minonte dialogun e Brukselit duke devijuar fokusin nga një zgjidhje afatgjatë, në adresimin e incidenteve sporadike.

Çështjet që mund të adresohen në periudhën afatshkurtër

Pjesëmarrësit identifikuan një numër të çështjeve që mund të adresohen në periudhën afatshkurtër.

1. Vlerësimi i marrëveshjeve të pazbatuara dhe identifikimi i pengesave për zbatimin e tyre.
2. Transformimi i marrëveshjes në letra ngjithëse në një zgjidhje të përhershme
3. Angazhim më intensiv për gjetjen e personave të zhdukur.

² Operatori Kosovar i Transmisionit (KOSTT) bëhet anëtar i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (ENTSO-E); do të themelohej një kompani e re e energjisë elektrike sipas kornizës ligjore dhe rregullative të Kosovës për të furnizuar me energji elektrike dhe për të ofruar shërbime të shpërndarjes (siç janë faturimi, mirëmbajtja dhe lidhja fizike e konsumatorëve të rinj) për klientët në katër komunat me shumicë serbe në veri, dhe do të jetë në gjendje të blejë dhe shesë energji në tregun e hapur; punëtorët e JP Elektrokosmet ose do të inkorporohen në këtë kompani të re ose mund t'u ofrohet punësim në Kompaninë Kosovare të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS); KOSTT do të rilidhë linjat 110 KV në nënstacionin Valac dhe operatorët aktualë në Valac do të respektojnë udhëzimet nga qendra dërguese e Kosovës; dhe të dyja palët pajtohen që të përpiqen të gjejnë një zgjidhje të përbashkët për sa i përket kërkesave të KOSTT-it dhe pretendimeve të EMS, operatori i transmisionit në Serbi. Nëse nuk është e mundur të arrihet një zgjidhje e përbashkët brenda 6 muajve, të dyja palët bien dakord t'i paraqesin këto pretendime në arbitrazhin ndërkombëtar.

³ Marrëveshja nuk u implementua. Dhe në vitin 2019, pasi pësuan ndërprerje në orët e tyre, BE rishikoi marrëveshjen origjinale pa miratimin e Serbisë dhe vazhdoi me zbatimin. U deshën katër hapa. a) Kompanisë serbe iu ofrua licenca në përputhje me ligjin e Kosovës. b) Shoqëria e refuzoi ofertën. Pas refuzimit, anëtarët e Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale (RGCE) të ENSCO-E votuan për një modifikim të Marrëveshjes origjinale të Energjisë së Brukselit. Anëtarët e RGCE hartuan marrëveshjen e re që hoqi regjistrimin e kompanisë serbe nga marrëveshja, duke lënë kështu KOSTT-in përgjegjës për furnizimin dhe menaxhimin e energjisë në gjithë territorin e Kosovës. Serbia e apeloj vendimin por humbi në procesin e votimit. Anëtarët e RGCE refuzuan kërkesën e Serbisë për të rishikuar ndryshimet në projekt-marrëveshjen e re, c) Anëtarët e RGCE votuan për marrëveshjen e modifikuar. Shumica ishte pro, kështu që KOSTT u bë anëtar i barabartë i ENTSCO-E.

4. Njohja e të gjitha diplomave.
5. Parandalimi një krize eventuale për energjinë elektrike në veri.
6. Ndërrmarja e hapave pajtues, siç janë takimet e drejtpërdrejta të liderëve të Kosovës dhe Serbisë.
7. Zgjidhja e çështjeve të dokumenteve të udhëtimit.
8. Bashkëpunimi policor në luftimin e krimit të organizuar dhe veprimtarisë së paligjshme ekonomike.
9. Përshpejtimi i zgjidhjes së çështjes pronësore të komuniteteve joshqiptare.
10. Rivitalizimi i Qendrës së Skijimit në Brezovicë duke i lejuar kompanitë kosovare dhe serbe të investojnë.
11. Zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit.
12. Fillimi i diskutimeve për formimin e Asociacionit/Bashkësisë.

Pjesëmarrësit u pajtuan që nevojitet një vullnet i fortë politik për trajtimin e këtyre çështjeve dhe periodat parazgjedhore nuk janë të përshtatshme për vendime të ndjeshme. Sidoqoftë, disa folës thanë që herët a vonë, liderët do të duhet të zgjidhin vetë problemet e tyre. “Askush nuk do ta bëjë këtë për ne. Për më tepër, “ne nuk duhet të lejojmë që zvarritja e zgjidhjeve të bëhet politikë.” Disa folës thanë se fjala “kompromis është një fjalë e mirë, por ne e kemi kontaminuar atë.”

Në përfundim, pjesëmarrësit rekomanduan angazhim më aktiv në ndërtimin e mbështetjes publike për dialogun përmes theksimit të avantazheve të një marrëveshjeje në krahasim me rreziqet. Dhe marrëveshja finale duhet të sigurojë që relacionet mes Serbisë dhe Kosovës të bëhen normale në mënyrë të pakthyeshme.

Pjesëmarrësit

Sipas rendit alfabetik anglez

Gresa Baftiu, Bashkëpuntore në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Gordana Comic, Ish-deputete e Parlamentit të Serbisë; Ministre për të Drejtat e Njeriut dhe Minoriteteve dhe Dialogut Social e Serbisë
Vladimir Djukanovic, Deputet i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Dubravka Filipovski, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Sadri Ferati, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Shpëtim Gashi, Nënkyetar, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Dukagjin Gorani, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës; Analist
Vincent Hug, Këshilltar për Siguri Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës
Dalibor Jevtic, Nënkyetar, Lista Serbe
Mimoza Kusari Lila, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Vesna Markovic, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Milivoje Mihajlovic, Analist
Petar Miletic, Ish-deputet i Parlamentit të Serbisë; Analist
Igor Novakovic, Bashkëpunor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Snezana Paunovic, Deputete e Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Fitore Pacolli, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Lulzim Peci, Drejtor, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Dejan Radenkovic, Deputet i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Jeta Statovci, Deputete e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Visar Ymeri, Ish-deputet i Parlamentit të Kosovës; Analist